

**SUPREME COURT OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA**

**KOSOVO PROPERTY AGENCY (KPA) APPEALS PANEL
KOLEGJI I APELIT TË AKP-ës
ŽALBENO VEĆE KAI**

GSK-KPA-A-104/2014

Prishtinë

14 prill 2016

Në çështjen juridike të

M.Z.

Rr. Goričani, Golubovci bb

Podgoricë

Mali i zi

Pala ankuese

Kolegji i Apelit të AKP-së, i Gjykatës Supreme të Kosovës, i përbërë nga Beshir Islami, Kryetar i Kolegjit, Anders Cedhagen dhe Anders Cedhagen, gjyqtarë të EULEX-it, lidhur me ankesën kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës (më tutje: KKPK-ja) KPCC/D/A/212/2013 (lënda e regjistruar në Agjencinë Kosovare të Pronës me numrin KPA90865) të datës 21 gusht 2013, pas shqyrtimit të mbajtur më 14 prill 2016, mori këtë

AKTGJYKIM

- 1. Refuzohet si e pabazuar ankesa e M.Z. kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/A/212/2013 të datës 21 gusht 2013, sa i përket kërkesës së regjistruar në AKP me numrin KPA90865.**

2. Vërtetohet vendimi i Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/A/212/2013, të datës 21 gusht 2013, sa i përket kërkesës së regjistruar në AKP me numrin KPA90865.

Përmbledhje e çështjeve procedurale dhe faktike:

1. Më 29 dhjetor 2006, M.Z. (më tutje: pala ankuese) ka paraqitur një kërkesë në Agjencinë Kosovare të Pronës (më tutje: AKP), duke kërkuar vërtetimin e të drejtës së pronësisë dhe ri-posedimin mbi një ngastër toke nr. 105, me sipërfaqe prej 2He 10Ar 0m², Zona Kadastrale Junik, Komuna e Deçanit (më tutje: prona e kërkuar).
2. Në kërkesë, pala ankuese deklaroi se prona e kërkuar ishte humbur për shkak të rrethanave që ndërlidhen me konfliktin e armatosur që ndodhi në Kosovë në vitet 1998/99, duke cekur 12 qershorin 1999 si datën e humbjes.
3. Së bashku me ankesën, pala ankuese i dorëzoi këto dokumente:
 - Procesverbalin e Këshillit të Komunës së Deçanit dhe Institutit Gjeodezik të Republikës së Serbisë mbi Ndarjen Shtesë të Ngastrave Tokësore Bujqësore Pronarëve të Ardhshëm, lëshuar më 14 qershor 1996. Ky dokument tregon se pala ankuese ka qenë e “informuar se është i ftuar si përfaqësues i kësaj bashkësie familjare për pranim-dorëzim” të pronës së kërkuar.
 - Vendimi për Ndarje nr. 140-461-112/97-01 i lëshuar nga Ministria e Financave të Republikës së Serbisë në Beograd më 23 qershor 1997, përmes së cilit ngastrat kadastrale nr. 4131/2, me sipërfaqe prej 0Ha 06Ar 14m² dhe nr. 4132/2, me sipërfaqe prej 2He 03Ar 83m² (lëndë e një kërkesë tjetër nr. KPA17714 dhe jo e kësaj kërkesë nr. KPA90865) i ishin ndarë palës ankuese dhe anëtarëve të bashkësisë së tij familjare (S., D., M., K., S.).
 - Çertifikata e Regjistrimit të palës ankuese si person i zhvendosur nr. 28001457 të lëshuar nga Komisarjati për Personat e Zhvendosur të Republikës së Malit të zi.
4. Më 28 maj 2010, AKP-ja e njoftoi pronën e kërkuar përmes publikimit në Gazetën nr. 1 dhe në Buletinin e Zyrës për Prona të UNHCR-së. Ekipi Njoftues i AKP-së i vendosi publikimet në hyrje dhe dalje të qytezës Junik. Të njëjtat u publikuan në Komunën e Junikut, në Kadastër, në Gjykatën e Deçanit, në Zyrën Rajonale të AKP-së në Pejë, dhe në institucione tjera (DRC, OSBE, UNHCR, Agjencia Kosovare e Privatizimit, EULEX dhe në Ombudsperson).

5. Sipas raporteve të verifikimit të Sekretarisë Ekzekutive të AKP-së, asnjë dokument që është dorëzuar nga pala ankuese nuk është verifikuar si i vërtetë.
6. Më 21 gusht 2013, KKPK-ja me Vendimin KPCC/D/A/212/2013 e refuzoi kërkesën. Në paragrafin 74-75 të vendimit grupor, që sipas vendimit të vërtetuar vlen posaçërisht për kërkesën, theksohet se pala ankuese gjithashtu dorëzoi procesverbalin nga seanca e përfaqësuesve të Komunës së Deçanit dhe Institutit të Arkitekturës dhe Urbanizmit të Republikës së Serbisë të vitit 1996, gjatë së cilit palës ankuese i ishte ndarë prona e kërkuar. I njëjti vendim arsyeton se procesverbali i përmendur dhe vendimet ishin të bazuara në një ligj që ishte shfuqizuar me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 1999/10 të datës 13 tetor 1999 mbi bazën e të qenit diskriminues. Për më tepër, vendimi thekson se pala ankuese është kontaktuar në disa raste duke iu kërkuar atij që të dorëzojë dokumente shtesë në mënyrë që ta dëshmojë të drejtën e pretenduar pronësore, por ai nuk ka dorëzuar prova tjera. Në fund, KKPK-ja konkludon se pala ankuese nuk ka arritur ta tregojë pronësinë apo ndonjë të drejtë tjetër pronësore mbi pronën e kërkuar.
7. Më 25 shkurt 2014, vendimi iu dorëzua palës ankuese dhe ai paraqiti ankesë më 18 mars 2014.

Pretendimet e palës ankuese:

8. Pala ankuese pretendon se KKPK-ja i ka vërtetuar faktet në mënyrë të gabuar dhe jo të plotë, dhe se gjithashtu ka bërë zbatim të gabuar të së drejtës materiale dhe shkelje të së drejtës procedurale.
9. Pala ankuese pretendon se vendimi i KKPK-së gabimisht e ka përmendur ngastrën me numër. 105 (prona e kërkuar), pasi që sipas tij ngastrat e kontestuara janë me numrat. 4131/1 dhe 4132/2. Gjykata Supreme vëren se këto ngastra janë lëndë e kërkesës nr. KPA17714, që është vendosur me vendimin e KKPK-së nr. KPCC/D/A/188/2013, të datës 13 shkurt 2013, dhe jo lëndë e kërkesës në fjalë nr. KPA90865 të vendosur me vendimin e KKPK-së nr. KPCC/D/A/212/2013 të datës 21 gusht 2013, kundër të cilit pala ankuese paraqiti ankesë. Pala ankuese deklaroi se vendimi i KKPK-së nuk i referohet lëndës së tij në “asnjërin prej segmenteve të saj”.
10. Pretendimet tjera që pala ankuese i paraqiti në ankesën e tij kanë të bëjnë me ngastrat nr. 4131/1 dhe nr. 4132/2 dhe jo me pronën e kërkuar (nr. 105).

11. Në fund, pala ankuese kërkon që Gjykata Supreme ta anulojë vendimin e KKPK-së lidhur me kërkesën nr. KPA90865 si të paligjshme për shkak të shkeljes serioze të procedurës, apo ta rishikojë atë me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike dhe të jep vendim të ligjshëm dhe t'ia kthejë pronën e kërkuar atij. Pala ankuese nuk ka dorëzuar ndonjë dokument tjetër që do të mund të konsiderohej si provë e re që e mbështet pretendimin e tij pronësor.

Arsyetimi ligjor:

Pranueshmëria e ankesës

12. Ankesa është e pranueshme sepse është paraqitur brenda 30 ditësh sikurse parashihet me nenin 12.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 mbi Zgjidhjen e kërkesave që ndërlidhen me pronën e paluajtshme private, përfshirë pronën bujqësore dhe komerciale, e ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079 (me tutje: Rregullorja e UNMIK-ut 2006/50).

Meritat e ankesës

13. Pas shqyrtimit të shkresave të lëndës dhe pretendimeve të palës ankuese, në përputhje me nenet 12 dhe 13 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 dhe nenit 194 të Ligjit nr. 03/L-006 për Procedurën Kontestimore, Gjykata Supreme konstatoi se ankesa është e pabazuar. Arsyetimi për këtë konkludim është në vijim.
14. KKPK-ja e bazoi vendimin e saj në faktin se Sekretaria Ekzekutive e AKP-së ka bërë një verifikim negativ të dokumenteve mbi të cilat pala ankuese e ka bazuar kërkesën e tij pronësore. Sekretaria Ekzekutive e AKP-së nuk kishte qenë në gjendje të sigurojë *ex officio* ndonjë provë që mbështeste kërkesën e palës ankuese (kërkesa nr. KPA90865). Bazuar në këtë, KKPK-ja konstatoi se pala ankuese kishte dështuar të vërtetojë ndonjë të drejtë pronësore mbi pronën e kontestuar.
15. Nuk janë paraqitur prova të reja së bashku me ankesën.
16. Gjykata Supreme konstaton se KKPK-ja ka marrë vendim të drejtë, duke u bazuar në procedurë të plotë dhe korrekte. Rrjedhimisht, Gjykata Supreme konstaton se nuk ka pasur shkelje të së drejtës materiale apo vërtetim të mangët të fakteve. Për më tepër, nuk janë paraqitur prova të reja së bashku me ankesën. Prandaj, Gjykata Supreme konstaton se ankesa nuk është e bazuar.

17. Gjykata Supreme nuk i mbështet pretendimet e palës ankuese se vendimi i KKPK-së gabimisht e ka përmendur pronën e kërkuar (ngastrën nr. 105) dhe jo ngastrat me numrat 4131/1 dhe 4132/2, që sipas tij janë pronat e kontestuara. Kjo ngase ngastrat me numrat 4131/1 dhe 4132/2 ishin lëndë e kërkesës së palës ankuese nr. KPA17744 (një kërkesë tjetër u paraqitur në AKP) të vendosur nga KKPK-ja me vendimin e saj KPCC/D/A/188/2013, të datës 13 shkurt 2013, me të cilin kërkesa në fjalë ishte refuzuar. Për më tepër, pala ankuese (e njëjta palë ankuese sikurse në këtë lëndë – KPA90865) kishte paraqitur ankesë kundër atij vendimi, ndërsa Gjykata Supreme vendosi për të me Aktgjykimin e saj GSK-KPA-A-266/13 më 17 shtator 2014 [Vendimi i KKPK-së (KPCC/D/A/188/2013, i datës 13 shkurt 2013) ishte anuluar dhe kërkesa e palës ankuese nr. KPA17744 ishte hedhur poshtë si e papranueshme].
18. Në fakt, para këtyre veprimeve të ndërmarra, pala ankuese e ka paraqitur kërkesën nr. KPA17744 (AKP-ja e quajti kërkesa fillestare – shih faqen 2 të shkresave të lëndës KPA90865) para AKP-së më 29 dhjetor 2006, duke kërkuar ri-posedimin e ngastrave me numrat. 105 (ngastra e kërkuar), 4131/1 dhe 4132/2. Për më tepër, për shkak se këto ngastra nuk ndodheshin pranë njëra tjetrës, AKP-ja e ndau kërkesën nr. KPA17744 në një kërkesë të re të AKP-së me numër KPA90865.
19. Prandaj, pretendimi i palës ankuese se vendimi i ankimuar i KKPK-së përmban gabim sa i përket ngastrës së kontestuar nuk qëndron. Kjo për faktin se ngastrat me numrat 4131/1 dhe 4132/2, si dhe prona e kërkuar (ngastra nr.105) janë trajtuar dhe vendosur nga KKPK-ja në dy vendimet e saj [(KPCC/D/A/188/2013 (lënda e regjistruar në AKP me numrin KPA17744), të datës 13 shkurt 2013 dhe KPCC/D/A/212/2013 (lënda e regjistruar në AKP me numrin KPA90865), të datës 21 gusht 2013)].
20. Duke i pasur parasysh të lartcekurat dhe në përputhje me nenin 13.3 nën (c) të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50, është vendosur sikurse ne dispozitivin e këtij aktgjykimi.

Këshillë ligjore

Në përputhje me nenin 13.6 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50, ky aktgjykim është i plotfuqishëm dhe i detyrueshëm dhe nuk mund të kundërshtohet përmes mjeteve të zakonshme apo të jashtëzakonshme juridike.

Beshir Islami, Kryetari i Kolegjit

Anders Cedhagen, Gjyqtar i EULEX-it

Krassimir Mazgalov, Gjyqtar i EULEX-it

Sandra Gudaityte, Referent i EULEX-it